

Punimet e Këshillit Drejtues të BSPK-së



Prishtinë 22 dhjetor 2011 - Nën kryesinë e Haxhi Arifit, kryetar, më 20 dhjetor 2011, është mbajtur mbledhja konstituive e Këshillit Drejtues të BSPK-së. Kryetari Arifi fillimisht i përshëndeti delegatët e pranishëm. Më pastaj, bëri një prezentim të shkurtër mbi mbarëvajtjen e Kongresit të VI-të të jashtëzakonshëm të BSPK-së. Gjithashtu, para delegatëve kryetari i BSPK-së lexoi edhe një letër të dërguar nga ITUC-u, të dërguar Presidentes së Kosovës, Kryeministrit të Kosovës dhe Ministrit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës. Në atë letër Sekretarja e përgjithshme e ITUC-ut i jep mbështetje të plotë Kongresit të VI-të të Jashtëzakonshëm të BSPK-së, të mbajtur në Gjakovë. Më tej, ai para delegatëve shpjegoi edhe plotësim-ndryshimet e propozuara në Statutin e BSPK-së dhe të miratuara në Kongres.

Delegatët votuan për konstituimin e KD-së të parë, pas Kongresit të VI-të të jashtëzakonshëm të BSPK-së. Nga gjithësej 46 delegatë të paraparë me statut që të marrin pjesë në mbledhje të pranishëm ishin 36 prej tyre.

Në mënyrë unanime, delegatët e Këshillit Drejtues (KD) votuan për miratimin e Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues të BSPK-së. Kryetari i BSPK-së bëri një sqarim të ndryshimeve statutare, të cilat kanë kaluar në Kongres. Një ndryshim i miratur ishte edhe e drejta e Koordinatorëve të Zyreve Regjionale të BSPK-së që të jenë pjesë e Kongresit dhe Këshillit Drejtues të BSPK-së me të drejtë vote.

Ndryshim tjetër është edhe ulja e numrit të anëtarëve të një Sindikate nga 1 000, në 500 për të fituar të drejtën e parashtrimit të kërkesës për të qenë Degë e BSPK-së me të drejta të plota. Në vazhdim u propozuan kandidatët për Nënkryetar të BSPK-së, kandidatët për Kryetar dhe Nënkryetar të KD-së të BSPK-së.

Me votim unanim nga të gjithë delegatët e pranishëm, u zgjodhën Nënkryetar të BSPK-së: Shefqet Hadërxhonaj dhe Avni Ajdini. Ndërsa kryetar i Këshillit Drejtues (KD) u zgjodh: Asllan Zejnullahu. Nënkryetar i Këshillit Drejtues (KD) Abedin Haxhiu dhe një pozitë vakante për degën e Administratës. ***